

FJALA E DEPUTETIT BLEDAR ÇUÇI

E HËNË 20 DHJETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Policia e Shtetit po bëhet gjithmonë e më tepër një institucion, një organizëm, më i pavarur dhe më profesional, por, gjithmonë, kur rrisim pavarësinë e institucioneve e aq më tepër të institucioneve si Policia e Shtetit, veprimtaria e të cilës lidhet drejtpërdrejtë me zbatimin e të drejtave themelore të njeriut, ne duhet të përmirësojmë dhe të rishikojmë gjithmonë instrumentet monitoruese të punës së tyre.

Dhe sot kemi sjellë për të miratuar në parlament një ligj të rëndësishëm, ligjin “Për agjencinë e mbikëqyrjes policore”. Ju tashmë jeni njohur me disa nga tiparet kryesore të këtij ligji, i cili është diskutuar gjatë dhe miratuar tashmë në komisione. Këtu gjej rastin të falënderoj të dy komisionet dhe kryetarët e komisioneve, përkatësisht Komisionin e Ligjeve dhe Komisionin e Sigurisë, por veçanërisht kolegen Felaj, nën udhëheqjen e së cilës një grup i përbashkët i të dy komisioneve arriti të konsolidonte një draft dhe ta përmirësonte atë për ta sjellë në formën më të mirë sot për miratim. Pra, tiparet kryesore të ligjit dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij ligji ju i dini tashmë. Dua të theksoj se nisma është pjesë e një pakete tërësore për reformimin e strukturave të sigurisë, për t’i sjellë ato në standardet më të mira europiane dhe të njohura botërisht. Ligji aktual i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat nuk është shumë i vjetër, por dinamika e zhvillimeve vitet e fundit, sidomos në sistemin e drejtësisë, por edhe faktorë të tjerë ligjorë dhe institucionalë, kanë bërë të detyrueshëm draftimin e këtij ligji të ri, që të përmbushë nevojat e krijuara dhe t’i përgjigjet kësaj shtate re të krijuar nga ndryshimet institucionale dhe ligjore. Një element tjetër shumë i rëndësishëm, që u shtohet nevoja për reformim rrënjësor të SHÇBA-së, lidhet me rekomandimet e partnerëve tanë ndërkombëtarë në fushën e rendit dhe sigurisë, dhe kryesisht rëndësia për t’u përputhur me standardet e European Partnership Against Corruption ose të EPAC-ut. Dua të them që në fillim se ligji është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me specialistët e ICITAP-it dhe ka kaluar, gjithashtu, në procesin e konsultimit publik, gjatë të cilit janë përfshirë institucione të ndryshme, subjekte të ligjit, por edhe partnerë ndërkombëtarë, që asistojnë në fushën e rendit dhe sigurisë publike. Po cilat janë disa nga synimet kryesore të kësaj nisme ligjore? Së pari, reformimi i Shërbimit, i cili tashmë do të quhet Agjenci, si një agjenci inteligjente për të luftuar korrupsionin dhe për të parandaluar veprimtarinë e paligjshme në radhët e subjekteve të saj, duke e përfruar me agjencitë homologe të vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Së dyti, transformimi i Shërbimit, tashmë Agjencisë, drejt një modeli më demokratik e institucional, si pjesë e komunitetit të agjencive ligjzbatuese e inteligjente në vend, sipas standardeve të EPAC-ut. Së treti, rritja e kapaciteteve të Shërbimit, tashmë Agjencisë, për një qasje proaktive ndaj fenomeneve korruptive të subjekteve të Shërbimit. Së fundi, parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi paraprak i veprimtarisë kriminale e korruptive në subjektet e Shërbimit.

Risitë kryesore të projektligjit. Risi kryesore të këtij projektligji, në radhë të parë, është kalimi i kësaj strukture, i këtij instrumenti, në një strukturë civile, pra zhveshja nga gradat dhe krijimi i një strukture civile, me një zhvillim të qartë karriere dhe duke shmangur konfliktin e interesit me subjektet që

mbikëqyr. Thënë ndryshe, tashmë Shërbimi nuk është një rrjedhë normale, ku oficerë të Policisë Gjyqësore mund të shkojnë dhe të shërbejnë në Agjencinë Mbikëqyrëse dhe, në të kundërt, kur mbarojnë misionin e Agjencisë, të kthehen në Policinë e Shtetit me gradat përkatëse, sipas gradave të Policisë së Shtetit, por është një agjenci tërësisht civile, duke shmangur kështu një konflikt të hapur interesi, që lind në këto raste. Risi tjetër, ky projektligj përcakton detyrimet që rrjedhin nga aktet e tjera ligjore, si ai për “Vlerësimin kalimtar dhe periodik të subjekteve mbikëqyrëse”. Në ligjin 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës dhe SHÇBA-së”, kjo strukturë ka marrë funksione të reja, të cilat duhet të pasqyrohen detyrimisht në ligjin organik që e rregullon këtë Agjenci. Dhe së fundi, veprimtaria verifikuese për pajisjen me certifikata të sigurimit të personelit (CSP) të subjekteve. Ky detyrim ka lindur pas miratimit të VKM-së përkatëse “Për miratimin e rregullave të sigurimit të personelit”, i cili i jep të drejtën Shërbimit (Agjencisë tashmë në të ardhmen), si autoritet verifikues, për pajisjen me certifikatë sigurie të subjekteve, që, për shkak të detyrës, duhet të njihen me informacionin e klasifikuar.

Aktualisht, veprimtaria e pajisjes me certifikatë sigurie ndiqet edhe nga Policia e Shtetit, edhe nga SHÇBA-ja. Në të parën bëhet aplikimi, ndërsa në të dytën bëhen verifikimi dhe përcjellja nga SHÇBA-ja drejt organit kompetent. Në lidhje me këtë përgjegjësi të re, pra kalimin vetëm në një dorë, pra e bërë vetëm nga Agjencia tashmë, ku Agjencia merr përgjegjësinë për subjektet e saj që të udhëheqë që prej fillimit, pra që nga faza fillestare e aplikimit e deri në përfundim të plotë të praktikës, duke kryer veprimtarinë verifikuese dhe duke ia dërguar për kompetencë DSIK-së, me konkluzionin nëse ekziston ose jo kushti i sigurisë, dua të jem i qartë se nuk bëhet fjalë për marrjen e atributit të vendimmarrjes për pajisjen me certifikatë sigurie të personelit, pasi atë e ka vetëm DSIK-ja. Një risi tjetër lidhet me procesin e ekzaminimit poligrafik. Ekzaminimi poligrafik ka lindur si detyrim nga ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe është parashikuar si një nga fazat e rekrutimit të personelit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, pra bërja e ekzaminimit poligrafik për të gjithë personelin që do të punojë në Byronë Kombëtare të Hetimit. Ka qenë, sigurisht deri më sot, për informacion, një projekt i asistuar nga ambasada e SHBA-së. nëpërmjet programit të ICITAP-it, dhe tashmë kemi trajnuar 5 ekspertë, që do t’i atashohen Agjencisë në të ardhmen. Së fundmi, por me rëndësi të madhe, një risi e projektligjit është hetimi disiplinor që do të bëjë Agjencia ndaj subjekteve që mbikëqyr, për të gjitha shkeljet e rënda, të cilat konstatohen nga vetë Agjencia gjatë veprimtarisë së saj mbikëqyrëse, si dhe detyrimi që do të kenë subjektet e agjencisë për të zbatuar konkluzionet e hetimit disiplinor. Sipas rekomandimeve të ekspertëve të ICITAP-it dhe standardeve të EPAC-ut, që jua përmenda më parë, strukturat që mbikëqyr Agjencia do të ishin në konflikt të hapur interesi, sikundër deri tani, nëse ankesat apo shkeljet, që konstatohen nga Agjencia, do të hetoheshin nga vetë strukturat, ku janë me detyrë subjektet përkatëse. Kjo nevojë del edhe më e evidente në rastet e incidenteve të rënda, të cilat krijojnë impakt dhe ndjeshmëri të lartë të qytetarët dhe për të cilat duhet të ketë një hetim të pavarur dhe transparent për publikun, si dhe të evitohet çdo konflikt interesi real apo i perceptuar.

Të nderuar kolegë, pas një konsultimi të gjatë të këtij projektligji me grupet e punës dhe, siç e thashë, edhe me komisionet parlamentare dhe grupet e tjera të interesit, kam bindjen se ky është një produkt ligjor cilësor, në funksion të rritjes së sigurisë dhe luftës kundër korrupsionit, një produkt ligjor që do t’i rezistojë kohës, do të shërbejë për ndërtimin e institucioneve më të mira, që kanë besueshmëri më të lartë të publikut dhe, për rrjedhojë, të një shoqërie më të mirë. Për këto arsye ju ftoj të gjithëve ta miratojmë këtë ligj. Faleminderit!